



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 61, datë 01.06.2020

**“PËR
DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.157, DATË 26.12.2019, TË KËSHILLIT
BASHKIAK “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
2020-2022 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANËS PËR
VITIN 2020”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b”, pika 1.3 shkronja “c” nenit 41, pika 1, neni 54, shkronja “dh”, nenit 55, pikat 3 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 113 të Ligjit nr.44/2015, datë 30.04.2014 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 88/2019 “Për Buxhetin e vitit 2020”; nenit 43 dhe nenit 44 të Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Udhëzimit plotësues nr.2 datë 20.01.2020 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave për “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të Vendimit nr.377 datë 08.05.2020 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr.1/241, me emërtimin “Teatri Kombëtar” në Zonën Kadastrale 8150 Tiranë”, Vendimit nr.50, datë 14.05.2020 të Këshillit Bashkiak Tiranë, “Për miratimin e shembjes së Godinës të “Teatrit Kombëtar” pasuri në pronësi të Bashkisë Tiranë, bazuar në akt-ekspertizën e hartuar nga Instituti i Ndërtimit “Mbi vlerësimin e Godinës së Teatrit Kombëtar”, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

Në vendimin nr.157, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020”, bëhen këto ndryshime:

1. Në nënpikën 1 të pikës 1 bëhen ndryshimet si më poshtë :

Në Lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2019	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021	Parashikimi 2022
Të ardhura të taksueshme	8,972,750,000	10,180,826,000	9,420,602,000	9,428,304,200
Të ardhura jo tatimore	4,386,280,000	4,443,420,000	4,708,187,000	4,792,903,000
Total të ardhura	13,359,030,000	14,624,246,000	14,128,789,000	14,221,207,200
Transferta e Pakushtëzuar e përgjithshme	2,348,723,419	2,424,942,357	2,740,160,004	2,927,708,309
Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	1,159,433,601	1,176,039,602	1,250,000,000	1,300,000,000
Total Transferta	3,508,157,020	3,600,981,959	3,990,160,004	4,227,708,309
Të ardhura të mbartura	1,500,000,000	2,178,800,000		
Totali	18,367,187,020	20,404,027,959	18,118,949,004	18,448,915,509

2. Në nënpikën 1 të pikës 2 bëhen ndryshimet sipas pasqyrës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Të miratojë rishpërndarjen e shpenzimeve korrente dhe kapitale brenda Programit të Arsimit të Mesëm të Përgjithshëm, Programit të Trashëgimisë Kulturore dhe Eventet Artistike dhe Kulturore ,Programit të Rrjetit Rrugor dhe Programit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile sipas pasqyrës nr.2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore për zbatimin e këtij vendimi.

5.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit Ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

TONI GOGU

Konceptoi:
E.Demiraj